



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr 806 Prot.

Tiranë, më datë 08.062021

VENDIM
Nr. 277, datë 08.06.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 08.06.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e konceptit të Sondazhit arkeologjik në kuadër të projektit me objekt “Strukturë banimi 2 kat + 1 kat nëntokë dhe rikonstruksion i banesës ekzistuese 1 kat + rrethim i pronës, Lagja Nr. 1, Rruga “Kuvendi i Vlorës” brenda kufirit të Zonës Arkeologjike “B” të qytetit të Durrësit”, aplikues “JF Architecture Designer” sh.p.k. dhe zhvillues Adnan Quku, paraqitur nga subjekti i licencuar në arkeologji z. Taulant Rama;
2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji z. Taulant Rama, i cili do të realizojë sondazhet arkeologjike për projektin “Strukturë banimi 2 kat + 1 kat nëntokë dhe rikonstruksion i banesës ekzistuese 1 kat + rrethim i pronës, Lagja Nr. 1, Rruga “Kuvendi i Vlorës” brenda kufirit të Zonës Arkeologjike “B” të qytetit të Durrësit”, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt;
3. Rezultati i Sondazhit arkeologjik të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje në KKTKM;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

